



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1089/Prot.

Tiranë, më 10.11.2015

Lënda: Jepet mendim mbi projektligjin “Për shoqëritë e Kursim Kreditit dhe disa Unione të tyre”.

Drejtuar: **Z. Shkëlqim CANI**
MINISTËR I FINANCAVE

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj Nr. 14007/7 Prot, datë 27.10.2015, për dhënie mendimi mbi projektligjin “Për shoqëritë e Kursim Kreditit dhe disa Unionet e tyre”, do të vlerësonim përshtatjen e projektligjit me sugjerimet e mëposhtme.

Në nenin 13 “Të drejtat e anëtarit”, pas shkronjë e) të shtohet një shkronjë me këtë përmbajtje:

*“Çdo anëtar ka të drejtën për t’u informuar nga SHKK-ja dhe Unionet e tyre për:
Përpunimin ose jo të të dhënave personale
për qëllimin e përpunimit;
për kategoritë e të dhënave të përpunuara;
për marrësit dhe kategoritë e marrësve, të cilëve u përhapen të dhënat”*

Në nenin 15 “Përfundimi i anëtarësisë”, pas pikës 3) të shtohet një pikë në të cilën të përcaktohet koha e ruajtjes së të dhënave pas përfundimit të anëtarësisë. Afati duhet të lidhet me përfundimin e qëllimit të përpunimit të të dhënave dhe me realizimin ose përbushjen e qëllimit të dhënat duhet të fshihen dhe mos të bëhen publike.

Në nenin 68 “Detyrimi për ruajtjen e sekretit profesional”, pas pikës 2) të shtohet një pikë me këtë përmbajtje:

“Kategoritë e subjekteve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, të cilët njihen me informacionin e përshkruar sipas pikës 1, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë gjatë dhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj”.

Në nenin 76 “Shkeljet për të cilat jepen masat”, pas shkronjës “ë”) të shtohet një shkronjë me këtë përmbajtje:

“Kërkon informacion nga Rregjistri i Kredive për anëtarët e SHKK, pa kryer verifikimet e nevojshme në lidhje me identitetin dhe të dhënat personale”.

Në nenin 106 “Regjistri i kredive”, pas pikës 2) të shtohet një pikë me këtë përmbajtje:

“ ShKK dhe unionet e tyre përpunojnë të dhënat personale në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Gjithashtu, sjellim në vëmendjen tuaj se pas sugjerimit që bëjmë për të shtuar nenin 68 të projektligjit, neni 98 mbetet të jetë përsëritje e tij.

Në përfundim, me integrimin e sugjerimeve të mësipërme, projektligji vlerësohet i hartuar konform kërkesave të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Besnik DERYISHI

KOMISIONER

